



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:063248

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06534858

CA.nr.3340/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses-propozueses të masës së sigurisë A.S., me vendbanim Rr. “S. Ç.” nr.27, P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.A., avokat në P., me autorizim, kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Rruga e Shkronjave, Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Rektori Universitetit Prof. Asoc. Dr. S. K., duke vendosur lidhur me propozimin e paditëses-propozueses për masë të sigurisë, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 02.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET propozimi i paditëses-propozueses A.S., me vendbanim Rr. “S. Ç.” nr.27, P., për caktimin e masës së sigurisë, përmes të cilit ka kërkuar që të PEZULLOHET nga puna Dr.Sc. K. G. që të ushtrojë detyrën Profesor-Asistent në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Ukshin Hoti në Prizren, për lëndët Menaxhimi i Cilësisë, Sistemi Informatikë i Menaxhimit, E-Biznesi, Aftësi Negociuese-Lidership, Ekonomiksi Menaxherial, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti më Aktgjykim të formës së prerë. Të Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit Ukshin Hoti në Prizren, që gjatë kohës së Pezullimit nga detyra e Dr. Sc. K.G., të autorizoj një mësimmshënës tjetër, të përkohshëm për mbajtjen e mësimit.

A r s y e t i m

Paditësja-propozuesja A.S., me vendbanim Rr. “S. Ç.” nr.27, P., përmes të autorizuarit të saj, me datën 10.03.2023 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prizren, kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Rruga e Shkronjave nr.1, Prizren, me objekt kontesti anulim i vendimit.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses ka zhvilluar procedurën gjyqësore në këtë çështje kontestimore dhe ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.895/23, të datës

18.01.2024, me të cilin ka vendosur meritorisht, përkatësisht e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit C.nr.895/23, të datës 18.01.2024, i pakënaqur me vendimin i padituri ka parashtruar ankesë në gjykatën e shkallës së dytë. Lënda me ankesë është regjistruar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë me datën 21.03.2024, me numër CA.nr.3340/2024.

Lënda me numër CA.nr.3340/2024 sipas ankesës së të paditurit ende nuk është marr në shqyrtim nga kolegji i Gjykatës së Apelit dhe është në pritje për të vendosur sipas radhës.

I autorizuari i paditesës-propozuesës me datë 16.10.2024, në Gjykatën Themelore në Prizren për Gjykatën e Apelit të Kosovës ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë. Gjykata Themelore në Prizren me aktin përcjellës e ka e ka dërguar propozimin për masë në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Në propozim për caktimin e masës së sigurisë, paditësja - propozuesja ka theksuar se, duke u bazuar në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.895-2023, të nxjerr me datë 18.01.2024, në pikën II të dispozitivit, është anuluar Vendimi i Senatit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren të datës 20.02.2023, me nr.protokollit 01-111 për zgjedhjen e Dr. Sc. K.G., për lëndët Menaxhimi i Cilësisë, Sistemi Informatikë i Menaxhimit, E-Biznesi, Aftësi Negociuese-Lidership, Ekonomiksi Menaxherial. Duke i propozuar Gjykatës së Apelit që të aprovoj në tersi si të bazuar propozimin e propozueses me arsyetimin se, nëse i njëjti qëndron në pozitë të caktuar pune në bazë të një vendimi të anuluar nga Gjykata përben shkelje të rëndë ligjore si dhe shkelje të të drejtave të paditëses propozueses, të drejta këtij të garantuara me Kushtetutë. Me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj në tersi si të bazuar propozimin e propozueses.

Gjykata e Apelit pasi vlerësoi propozimin për caktimin e masës së sigurisë të paraqitur nga propozuesi dhe pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës erdhi në përfundim se për momentin, ky propozim është i pa bazuar dhe se i njëjti duhet të refuzohet.

Me dispozitën e nenit 297 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), është e paraparë që: *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, apo në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së kështillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Me nenin 300 par.1 të LPK-së, është e paraparë që: *“për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjese të tij, mund të caktohet disa lloje të masave të sigurimit”*, ndërsa në nenin 300 par.3 të LPK-së është paraparë se *“Masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre”*, Me dispozitën e nenit 301 par.1 është paraparë që *> Për sigurimin e të drejtave tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave, mund të caktohen këto masa sigurimi: a) ndalimi kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë aktivitetet e caktuara, po urdhri që t'i kryejë aktivitetet e tilla, me qëllim të ruajtjes së gjendjes ekzistuese apo pengimit të dëmtimit të palës kundërshtarë@ ndërsa me*

nenin 304.3 të LPK-së, është paraparë që< “*propozuesi në propozimin e tij duhet t’i tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe propozohen mjete provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim*”, si dhe që këto “*mjete provuese t’ia bashkangjes propozimit*”.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar propozimin e paditëses-propozuesës për caktimin e masës së sigurisë, bazuar në dispozitat e lartcekura të LPK-së, vlerëson se propozuesja e masës së sigurimit, nuk e ka bërë të besueshme të drejtën e saj subjektive, ngase propozimit të saj për caktimin e masës së sigurimit, nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë, e cila si e tillë do të ishte bindëse për gjykatën, për caktimin e masës së propozuar, përkatësisht nuk e ka dëshmuar në mënyrë bindëse të drejtën e saj subjektive, që gjykata të mund të veprojë sipas saj. Pretendimi i palës propozuese se lidhur me çështjen kryesore sipas padisë së paditëses propozuesës është vendosur me Aktgjykimin C.nr.895/2023 dhe se me të njëjtin është anuluar Vendimi i të paditurës i datës 20.02.2023 me nr. Protokollit 01-111, dhe se më masë të sigurisë duhet të pezullohet nga puna Dr.Sc. K. G., kjo nuk e bënë të besueshme të drejtën e saj subjektive për faktin se lënda është në procedurë të ankesës dhe për të nuk është vendosur ende, dhe se aprovimi eventual i aprovimit të masës së sigurisë në një formë do të paragjykonte zgjidhjen e çështjes kryesore, andaj edhe e refuzoi propozimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi për masë të sigurisë është vendim përmes të cilit sigurohet ruajtja e gjendjes ekzistuese, nga ndryshimi eventual që mund ta ndryshoj një gjendje të tillë, dhe se aprovimi apo refuzimi i një propozimi për caktimin e masës së sigurisë nuk e prejudikon zgjidhjen e çështjes kryesore, përkatësisht vendosjen lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktgjykimit C.nr.895-2023, të datës 18.01.2024.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e refuzoj propozimin e këtu propozueses për caktimin e masës së sigurisë duke vlerësuar se në rastin konkret, e njëjta nuk e ka arsyetuar e as argumentuar propozimin e saj në atë masë sa që i njëjti propozim të jetë i besueshëm dhe i pranueshëm për gjykatën.

Nga se u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 296.1, lidhur me nenin 142.5 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.3340/2024, me datë 02.12.2024

Kryetare e kolegjit

Hidajete Gashi Alaj, d.v.